



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 05 -2009
Prishtinë, më 23 shkurt 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Džezair Murati dhe Adem Hajdaraj.

Munguan: Branisllav Grbiq, Adem Salihaj, Selvije Halimi, Kolë Berisha dhe Armend Zemaj.

Të pranishëm: Lejla Selimi - OSBE, Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti, Blerta Ukmata - EULEX, Lumnije Murati - ZPRK, Nathalia Berkonitz - EULEX dhe Yordan Sirakov.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit .

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 9 shkurtit 2009;
3. Shqyrtimi i çështjeve të monitorimit të ligjeve;
4. Shqyrtimi i çështjes së procedimit të ligjit për të drejtat sendore;
5. Shqyrtimi i çështjes së përgatitjes së Projektligjit për hetim parlamentar;
6. Të ndryshme;

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Në fillim të mbledhjes i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falënderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit. Shpreson se kjo mbështetje do të vazhdojë edhe në të ardhmen, veçanërisht për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga Komisioni. I njoftoi të pranishmit për rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 9 shkurtit 2009

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit për vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i çështjeve të monitorimit të ligjeve

Kryetari - Në diskutimin e tij për shqyrtimin e çështjeve të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, shtoi se në planin e punës së Komisionit për vitin 2009, kemi paraparë ta mbikëqyrim zbatimin e dy ligjeve: njërin në mars, tjetrin në dhjetor. Është mirë në mars të mbikëqyret zbatimin e Ligjit penal për të miturit, në bashkëpunim edhe me organizatat që na mbështesin, në këtë rast me OSBE-në. Në vazhdim të diskutimit kryetari e shtroi çështjen e mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji, se a duhet të bëhet nga Komisioni apo të formohet një nënkomision.

Ibrahim Makolli - Duke u ndërlidhur me parafolësin shtoi se ky ligj është bukur voluminoz dhe duhet t'i gjejmë pikat ku do të mbikëqyret zbatimin e tij. Duhet të hartohen dinamika e mbikëqyrjes së zbatimit dhe plani i strategjisë për mbikëqyrjen e zbatimit. Të gjitha këto duhet të përfundojnë në mars, në mënyrë që të paraqiten para anëtarëve të Komisionit.

Me vendim të Komisionit u formua edhe nënkomisioni, që do t'i marrë përsipër edhe punët organizative për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të miturit, me këtë përbërje: Ibrahim Makolli, Armend Zemaj dhe Ramadan Gashi. Ky nënkomision do ta hartojë një raport që do të paraqitet para anëtarëve të Komisionit. Anëtarët e Komisionit u pajtuan me këtë vendim.

Kryetari - Në vazhdim shtoi se mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për faljen do të bëhet në dhjetor.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me këtë propozim.

4. Shqyrtimi i çështjes së procedimit të ligjit për të drejtat sendore

Kryetari – Lidhur me shqyrtimin e procedimit të Ligjit për të drejtën sendore shtoi se ky ligj është rikthyer në Kuvend. Grupi i punës e ka rregulluar përmbajtjen e këtij

ligji. Do ta shohim mundësinë e procedimit të mëtutjeshëm, që Ligji të procedohet edhe me tekstin e vjetër, edhe me tekstin e ri, sepse ka shumë nene (317) dhe po aq amendamente. Ne, si anëtarë të Komisionit, nëse kemi vërejtje, do t'ia paraqesim Komisionit.

Ramadan Gashi - Shtoi se në Ligjin për të drejtën sendore është punuar gjatë dhe mirë. Kemi bërë riformulime dhe saktësime, por kanë mbetur shumë amendamente. Duhet të bisedohet për mundësinë e procedimit të këtij ligji në Kuvend.

Bajram Kosumi - Ndër të tjera shtoi se ky ligj ka shumë amendamente, që ne duhet t'i kemi në Komision, kurse për Kuvend mund ta bëjmë një amendament për shprehjet gjuhësore ose 4-5 grupe të amendamenteve, në mënyrë që të procedohet sa më parë.

Ibrahim Makolli - Duke u ndërlidhur me parafolësit shtoi se ky ligj është shumë i rëndësishëm, madje është mirë të ketë edhe dëgjim publik për të. Amendamentet duhet të shqyrtohen një nga një, jo *an bllok*, sepse e dimë se edhe për një presje duhet të bëhet amendament i veçantë.

Adem Hajdaraj - Shtoi se në këtë ligj ekspertët e kanë dhënë kontributin e vet. Nuk e miratoj propozimin për dëgjime publike. Mendoj se Ligji duhet të shkojë me procedurë të shkurtuar në Kuvend.

Kryetari - Duke e përfunduar këtë pikë të rendit të ditës shtoi se ne, si Komision, duhet ta dërgojmë Ligjin në Kuvend me amendamente dhe në mënyrë të rregullt ta procedojmë. Të pranishmit e miratuan këtë propozim.

5. Shqyrtimi i çështjes së përgatitjes së Projektligjit për hetim parlamentar

Kryetari – Në këtë pikë të rendit të ditës shtoi se edhe në Planin e punës të Komisionit për vitin 2009 është paraparë që Komisioni ynë ta hartojë Projektligjin për hetim parlamentar. Është mirë të formohet një nënkomision për draftimin e këtij projektligji i cili më vonë do të diskutohet në Komision. Për këtë projektligj do të organizohen edhe dëgjime publike në objektet e Kuvendit të Kosovës.

Komisioni mori vendim që anëtarë të këtij nënkomisioni për hartimin e draftligjit për hetim parlamentar të jenë: Bajram Kosumi, Adem Salihaj, Dzezair Murati, Ramadan Gashi dhe Armend Zemaj.

Ky vendim u miratua nga anëtarët e Komisionit.

6. Të ndryshme

Kryetari – Në këtë pikë të rendit të ditës shtoi se ne, si Komision, do ta shqyrtojmë edhe bazën juridike të Projektligjit për gazin natyror. Vlerësoi se ky projektligj bazën juridike e ka në nenin 65 të Kushtetutës së Republikës të Kosovës.

Komisioni ia caktoi bazën juridike Projektligjit për gazin natyror dhe rekomandoi të procedohet për shqyrtim të mëtutjeshëm.

Komisioni diskutoi shkurtimisht edhe për raportin lidhur me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale, që e përgatiti Komisioni ynë. Ky do të shqyrtohet në seancën plenare të Kuvendit.

Procesverbali u hartua nga stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit
Bahri Hyseni